**V E N D I M**
**Nr. 61, datë 23.1.2003**

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Për Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës të jenë si më poshtë vijon:

I. Përfaqësues nga organizatat e punëmarrësve:

| | |
|---|---|
| a) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) | 5 anëtarë, 5 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) | 4 anëtarë, 4 kandidatë; |
| c) Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH) | 1 anëtar, 1 kandidat. |

II. Përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve:

| | |
|---|---|
| a) Konfederata e Punëdhënësve të Shqipërisë (KOP) | 4 anëtarë, 4 kandidatë; |
| b) Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH) | 3 anëtarë, 3 kandidatë; |
| c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Bashkimi i Industrialistëve dhe Investitorëve të Shqipërisë (BI&Ish) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Këshilli i Agrobiznesit shqiptar | 1 anëtar, 1 kandidat. |

2. Emërtimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me propozimin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

3. Vendimi nr. 768, datë 8.12.1998 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës", i ndryshuar me vendimin nr. 307, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

NUMRI I PUNONJËSVE TË SEKSIONEVE TË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS

| N/P | Emërtimi i Qarkut | Numri i punonjësve | Nëndarja administrative | Numri i punonjësve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BERAT | 8 | Berat<br>Kuçovë<br>Skrapar | 4<br>2<br>2 |
| 2 | FIER | 12 | Fier<br>Lushnjë<br>Mallakastër | 5<br>4<br>3 |
| 3 | GJIROKASTËR | 8 | Gjirokastër<br>Përmet<br>Tepelenë | 4<br>2<br>2 |
| 4 | DIBËR | 7 | Peshkopi<br>Bulqizë<br>Mat | 3<br>2<br>2 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | KUKËS | 7 | Kukës<br>Has<br>Tropojë | 3<br>2<br>2 |
| 6 | LEZHË | 7 | Lezhë<br>Kurbin<br>Mirditë | 3<br>2<br>2 |
| 7 | SHKODËR | 8 | Shkodër<br>M.Madhe<br>Pukë | 4<br>2<br>2 |
| 8 | VLORË | 10 | Vlorë<br>Delvinë<br>Sarandë | 5<br>2<br>3 |
| 9 | DURRËS | 7 | Durrës<br>Krujë | 4<br>3 |
| 10 | TIRANË | 7 | Tiranë<br>Kavajë | 4<br>3 |
| 11 | KORÇË | 11 | Korçë<br>Devoll<br>Kolonjë<br>Pogradec | 4<br>2<br>2<br>3 |
| 12 | ELBASAN | 10 | Elbasan<br>Peqin<br>Gramsh<br>Librazhd | 4<br>2<br>2<br>2 |
| | Totali | 102 | | 102 |